



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBOHOVË  
KRYETARI

---

## KONTRATE SIPERMARRJE

### OBJEKTI

*“Rikualifikimi urban i qendres se qytetit Libohove”*

2017

---

*Adresa: Libohovë  
Tel: 088122092*

E lidhur sot me date 02/03/2017,

midis paleve:

“Autoritetit Kontraktor”	Bashkia Libohove
Adresa	Libohove
Tel.	00355 881 220 92

perfaqesuar nga Kryetari i Bashkise , znj. Luiza Mandi

dhe kontraktuesit “ALBA KONSTRUKSION”, perfaqesuar nga perfaqesuesi ligjor/administratori, z. Xhavit Ismaili.

### Neni 1. Baza ligjore

Ligji nr. 7850, date 29.07.2002 “Kodi Civil i Republikes se Shqiperise” i ndryshuar,  
Ligji nr. 9643, date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik: i ndryshuar,

V.K.M. nr 914 , date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave tre prolurimit public”  
Ligji nr. 139/2015, “Per vetqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Kjo kontrate perpilohet sipas kushteve te pergjithshme te kontrates per zbatimin e punimeve me objekt te sipercituar.

Kontrata eshte me cmime te pandryshueshme.

### Neni 2. Perberja e kontrates

2.1 Kontrata do te perbehet nga dokumentacioni i meposhtem dhe dokumentet e tenderit te dates 30.05.2017, duke perfshire KPK dhe KVK ne dokumentet e tenderit:

1. Formulari i kontrates i nenshkruar nga palet me dokumentet e tenderit te cilesuar ne te,
3. Oferta teknike dhe ekonomike e paraqitur nga kontraktuesi ne tender dhe te pranuar nga Autoriteti Kontraktor, me specifikimet teknike, projekt-preventiv me cmimet per njesi dhe vleren sipas kontrates.

### Neni 3. Objekti i kontrates

Objekti i kesaj kontrate eshte “*Rikualifikimi urban i qendres se qytetit Libohove*”.

### Neni 4. Cmimi i kontrates

Autoriteti Kontraktor detyrohet t’i paguaje Kontraktorit per realizimin e objektit te kesaj kontrate, nje vlere prej **112.491.498,06** (njqind e dymbedhjete milione e katereqind e nentedhjete e nje mije e katerqind e nentedhjete e tete, zero gjashte )leke pa T.V.Sh. ose **134.989.797,68** (njqind e tridhjete e kater milione e nenteqind e tetedhjete e nente mije e shtateqind e nentedhjete e tete, gjashtedhjete e tete) leke me T.V.Sh. e percaktuar nga Kontraktuesi ne tenderin per siper marrjen e punimeve me realizimin e te gjitha punimeve qe perfshihen ne kete kontrate (preventiv).

### Neni 5. Afati i kontrates



Afati maksimal i kryerjes se punimeve te objektit te siperpermendur eshte 180 dite kalendarike, te llogaritura nga data e nenshkrimit te kontrates me mbikqyresin

## Neni 6. Gjuha e kontrates

Gjuha ne te cilen perpilohet kontrata eshte gjuha shqipe.

## Neni 7. Perkufizime

*“Preventiv total”* do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.

*“Preventiv per njesi”* do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.

*“Afati i realizimit te punimeve”* do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokures.

*“Kontratë”* do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

*“Cmim kontrate”* do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

*“Realizimi i punimeve”* do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

*“Defekt”* do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

*“Data e hyrjes”* do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.

*“Data e fillimit”* eshte perfshire ne Të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.

*“Pajisje”* do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.

*“Materiale”* do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.

*“Objekt i kontratës”* do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

*“Palë(t)”* do të thotë nënshkruesit e kontratës.

*“Drejtues projekti”* do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.

*“Autoritet Kontraktor”* do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

*“Kantier”* do të thotë vendi fizik i Punimeve.

*“Raport i inspektimit të kantierit”* do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojne informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.

*“Nënkontraktues”* do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.

*“Kontraktor”* do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.

"Standarte Teknike" do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

"Ngritja e kantierit" do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

"Punime" do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, dërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit

## Neni 8. Komunikimi

Komunikimi midis paleve do të bëhet vetëm me shkrim. Njoftimi bëhet efektiv vetëm pasi të dorëzohet dhe protokollohet.

## Neni 9. Prona intelektuale



- 9.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumenteve dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 9.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

## Neni 10. Mbikeqyresi i punimeve

Mbikëqyresi i punimeve do të jetë Ing. - \_\_\_\_\_, me licence Nr.MK \_\_\_\_\_, date \_\_\_\_\_, e vlefshme deri me \_\_\_\_\_ leshuar nga M.RR.T.T.  
Ne rast se mbikëqyresi ndryshohet, Autoriteti Kontraktor njofton menjëherë Kontraktuesin.

## Neni 11. Personeli i sipërmarrjesit

11.1 Sipërmarrësi do të punësojë personelin për kryerjen e funksioneve të parashikuara në programimin e miratuar nga Mbikëqyresi i Punimeve. Mbikëqyresi i punimeve do të miratojë çdo propozim për të zëvendësuar personelin kryesor. Në rast se Mbikëqyresi i Punimeve i kërkon me shkrim sipërmarrësit që të largojë nga puna një punonjës duke theksuar arsyet, sipërmarrësi do të marrë masa për t'u siguruar që personi në fjalë të largohet nga kantieri i punimeve brenda 72 orëve dhe të mos ketë më lidhje me punën e përfshirë në kontratë.



11.2 Drejtori Teknik i punimeve te objektit eshte z. \_\_\_\_\_ me licence nr. \_\_\_\_\_, date \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_.

Detyrat e drejtorit teknik jane si me poshte:


- ✓ Zbatimi i objektit konform projektit dhe kushteve teknike te zbatimit,
- ✓ Korrespondenca zyrtare me Mbiqyresin e punimeve,
- ✓ Dokumentacioni teknik qe eshte i detyrueshem te mbahet ne objekt,
- ✓ Ecuria e zbatimit te punimeve konform plan-organizimit dhe grafikut te punimeve,
- ✓ Eshte i pranishen ne te gjith afazat e realizimit te objektit: zbatimin e punimeve, dorezimin dhe kolaudimin e objektit.

11.3 Ne rast se ndryshohet drejtori teknik, Kontraktuesi duhet detyrimisht te lajmeroje mbiqyresin e punimeve, i cili ve ne dijeni investitorin.

#### Neni 12. Detyrimet e Sipermarresit

- a. Kontraktuesi do te kryeje punimet ne perputhje me projektet e ndryshimet e miratuara e te dhena nga Investitori dhe ne perputhje me K.T. te zbatimit te R.SH.
- b. Drejtori teknik i punimeve ne kantier eshte i detyruar te mbaje ditarin e objektit, ku te perfshihen te gjitha punimet e kryera dhe urdhrat e dhene per zbatimin e objektit. Ky ditar ne cdo kohe do t'i vihet ne dispozicion Mbiqyresit te punimeve, grupit te kolaudimit dhe investitorit.
- c. Kontraktuesi duhet te kryeje punime me nensiper marrje pasi te kete marre me pare miratimin e Autoriteti Kontraktor. Marredheniet e nensiper marrjes do te rregullohen nepermjet nje marreveshjeje, e cila percakton qarte nensiper marrjen dhe ne cdo rast eshte i detyruar te respektoje te gjitha detyrimet e kontrates se siper marrjes. Pergjegjes ndaj investitorit mbetet gjithmone Kontraktuesi.
- d. Kontraktuesi ka per detyre te ruaje projektin dhe te mos e perdore ate ne objekte te tjera jashte ketij tenderi. Gjithashtu, te mos jape asnje informacion (botim artikujsh, fotografish) mbi ecurine e punimeve pa lejen e investitorit.
- e. Kontraktuesi eshte i detyruar te marre te gjitha masat per kufizimin e ndotjes se ambientit, duke perdorur te gjitha mjetet ne dispozicion.
- f. Kontraktuesi eshte i detyruar te perdore mjetet e sinjalistikes rrugore per punime ne rruge me qellim disiplinimin e trafikut te mjeteve dhe kalimtareve ne objektin e ndertimit.
- g. Kontraktuesi eshte i detyruar te pajise punonjesit e tij me uniforma ne te cilat te shprehen shenja dalluese te shoqerise siper marrese.
- h. Ne rast te mosrespektimit te dispozitave te lartpermendura, mbiqyresi i punimeve i ben njoftim kontraktuesit per respektimin e detyrimeve. Nese siper marresi nuk merr masa brenda 10 diteve nga marrja e njoftimit, atehere Mbiqyresi i propozon Autoritetit Kontraktor aplikimin e nje penaliteti ne masen nga 50.000 deri ne 200.000 leke, penaliteti i cili do te mbahet nga situacioni pasardhes qe do te paraqitet per likuidim.

#### Neni 13. Testimet dhe Inspektimet



- 13.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës
- 13.2 Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspektime.
- 13.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspektime shtesë të parashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.
- 13.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 13.5 As egzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës

#### **Neni 14. Ngritja e kantierit**

Kontraktuesi mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

Kontraktuesi duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek Drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

#### **Neni 15. Zbulimet**


Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

#### **Neni 16. Sigurimi teknik**

Kontraktuesi mban përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier dhe rregullat e sigurimit teknik për të gjithë personelin sikurse përcaktohet në legjislacionin shqiptar.

#### **Neni 17. Rreziqet e Sipermarresit dhe Forca Madhore**

- 17.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës nga data e hyrjes deri në datën e realizimit të plotë për dëmtim personal, vdekje, humbje ose dëmtim të pasurisë dhe pasurisë shtesë që nuk janë në risqet e ndermarra nga kontraktuesi, dëmtim të materialeve, pajisjeve deri në masën e fajit.
- 17.2 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që



vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

- 17.3 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 17.4 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

## Neni 18. Sigurimi i Kontrates



- 18.1 Brenda 20 diteve nga marrja e njoftimit për fitimin e kontrates, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën 10% të vlerës së kontrates **13.919.723 (trembedhjete milion e nentëqind e nentëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e njetë e tre )** leke dhe formën e pranueshme sic specifikohet në kontratë në vlerë. Dështimi për të dhënë sigurimin e kontrates në formën dhe në shumën e kërkuar brenda 20 ditëve do të rezultojë në anulimin e kontratës dhe humbjen e sigurimit të Ofertës të kontraktorit.
- 18.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktorit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

## Neni 19. Preventivi

- 19.1 Preventiv për Njesi nëse është një kontratë me çmim njesie. Nëse është një kontratë me çmim njesie, Preventivi për Njesi do të përmbajë volumet e zerave të ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.
- 19.2 Preventivi për Njesi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në Preventivin në Njesi për secilin ze punimesh.
- 19.3 Për zerrat e rinj parashikohet në preventiv përveç dokumentacionit përkatës paraqitet dhe analiza teknike për çdo ze të ri punë.

## Neni 20 Kontrolli i cilesise

- 20.1 Kontraktori duhet të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilesise dhe zbatimin e kontrates
- 20.2 Sapo të lidhe kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilesise së aktiviteteve në zbatim të kontrates.
- 20.3 Drejtuesi i projektit i cili do të jetë z. **Foto Mangllara** specialist i urbanistikës pranë Bashkisë Libohovë duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.
- 20.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në këtë njoftim.



## Neni 21. Negociatat dhe Amendamentet

- 21.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.
- 21.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.
- 21.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

## Neni 22. Ndryshimi i Porosisë


- 22.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.
- 22.2 Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.
- 22.3 Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:
1. Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
  2. Korrigjime në materiale
  3. Korrigjime në sasi
- 22.4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.
- 22.5 Ndryshimi i porosisë nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk formalizohet sipas kërkesave.

## Neni 23. Programi

- 23.1 Brenda 5 diteve nga nënshkrimi i kontratës, Kontraktuesi do t'i paraqesë për miratim Mbiqyresit një program, në të cilin tregohet menyrja e kryerjes së punimeve dhe grafiku kohor. Kontraktuesi ka të drejtë t'i propozojë mbiqyresit të punimeve ndryshimin e grafikut të punimeve duke i motivuar ato.
- 23.2 Në rast se mund të lindë nevoja e dorezimit të pjesshëm të punimeve, këto parashikohen në grafikun e punimeve ose ndryshimet e propozuara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktor.

## Neni 24. Korrigjimi i defekteve

- 24.1 Sa herë që gjatë periudhës së zhvillimit të punimeve, nga Mbiqyresit konstatohet një defekt, Kontraktuesi është i detyruar ta korrigjojë atë brenda afatit që i lihet me shkrim, përveç me vonë se brenda 15 diteve.





- 28.1 Kontraktuesi do t'i paguaje Investitorit shperblimin per vonesa ne afatin e perfundimit te punimeve ne masen 0,04% ne dite te cmimit total te kontrates.
- 28.2 Sasia e pergjithshme e demeve te likuiduara nuk do te tejkaloje 25% te vleres se kontrates. Autoriteti Kontraktor do te zbrese demshperblimin per vonesat nga pagesat e fundit te Kontraktuesit.

#### Neni 29. Garancia e Defekteve

Garancia e Defekteve do t'ejete ne masen 5% te vleres se kontrates qe do t'i mbahet ne cdo situacion Kontraktuesit si garanci per cilesine e punimeve, shuma e se ciles do te paguhet pas periudhes se garancise se punimeve.

#### Neni 30. Kostoja e riparimeve


- 30.1 Demtimi i punimeve ose humbja e materialeve qe do te perdoren per punimet nga dita e fillimit deri ne marrjen ne dorezim te punimeve do te mbulohen nga Kontraktuesi.
- 30.2 Riparimet qe dalin te nevojshme gjate kolaudimit te vepres, nese jane per shkak te mosploresimit te kontrates ose te punes jocilesore te Kontraktuesit, do te mbulohen nga ky i fundit.

#### Neni 31. Marrja ne dorezim e punimeve

- 31.1 Kontraktuesi, pas perfundimit te punimeve, njofton me shkrim Mbikeqyresin e Punimeve dhe Autoritetin Kontraktor. Nese Mbikeqyresi i Punimeve nuk ka verejtje, ky njoftim shenon daten e perfundimit te punimeve. Sipermarresi, pas perfundimit te punimeve, i paraqet brenda 30 diteve Mbikeqyresit te punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet perfundimtare per punimet e kryera. Mbikeqyresi i punimeve pas verifikimeve brenda 30 diteve se bashku me relacionin e tij, ia paraqet te gjithe dokumentacionin investitorit.
- 31.2 Pas marrjes se dokumentacionit, investitori ia paraqet Komisionit te Kolaudimit te gjithe dokumentacionin e realizimit te vepres. Me perfundimin e procedurave te kolaudimit, Autoriteti Kontraktor leshon Certifikaten e marrjes ne dorezim te punimeve te kryera dhe do te cliroje Garancine e Sigurimit te Kontrates. Nga data e Akt-kolaudimit te punimeve fillon dhe periudha e garancise se punimeve.
- 31.3 Ne funde te periudhes se Garancise se punimeve, Mbikeqyresi i punimeve dhe komisioni i marrjes se punes ne dorezim te objektit, perpilojne se bashku me investitorin aktin e marrjes ne dorezim te vepres, objekt i kesaj kontrate.

#### Neni 32. Zgjidhja e Kontrates

- 32.1 Autoriteti Kontraktor ose Kontraktuesi, kur veren shkelje themelore te kontrates, kerkon zgjidhje te saj.
- 32.2 Shkeljet themelore te kontrates perfshijne por nuk kufizohen ne sa me poshte vijon:
- Kur nuk fillon pune brenda 5 diteve nga nenshkrimi i kontrates,
  - Mbikqyresi i punimeve urdheron pezullimin e punimeve duke niftuar Autoritetin Kontraktor dhe Kontraktuesin,



- c. Mosparrësi falimenton ose fillon likuidimin për arsye të tjera përveç rindertimit ose bashkimit të shoqërisë,
- d. Kontraktuesi vonon kryerjen e punimeve dhe nuk realizon korrigjimet e defekteve të propozuara nga Mbiqyrtuesi i Punimeve.

### Neni 33. Pagesa pas zgjidhjes së kontratës

Nëse kontrata prishet nga Autoriteti Kontraktor për arsye objektive, Mbiqyrtuesi i punimeve do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së kryer duke zbritur pagesat e marra deri në ditën e lëshimit të certifikatës.

### Neni 34. Pasuria

Të gjitha punimet e kryera dhe materialet e montuara për realizimin e objektit do të konsiderohen si prona e Autoritetit Kontraktor në rast prishjeje të kontratës.

### Neni 35. Zgjidhja e Mosparrëveshjeve

35.1 Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosparrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

35.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosparrëveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë

### Neni 36. Baza ligjore

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

### Neni 37. Dispozita të fundit


Kjo kontratë do të quhet e vlefshme nga data e nënshkrimit të saj nga të dyja palët. Kjo kontratë është hartuar në 4 (kater) kopje, tre nga të cilat i mban Autoriteti Kontraktor dhe një Kontraktuesi.

**AUTORITETI KONTRAKTOR**

**BASHKIA LIBOHOVE**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**LUIZA MANDI**



**KONTRAKTUESI**

**ALBA KONSTRUKSION**

**ADRIAN ISHEDERTI**

**XHA VITISMAJLI**

**Konstruksion**

**S.H.P.K**

**NIBP: J61812013R**

**TIRANA - ALBANIA**

